



Drejtoria Komunale e Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje
Department of Education

Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032, të datës 29.08.2011, neni 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018, Për Normativ për Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

Konkurs

Për plotësimin e vendit të lirë të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2019/20.

I. SHFMU"Sadidin Hajda" Rahovec.

Një Edukator/e

II. SHFMU"Lidhja e Prizrenit" Opterushë

Një Edukator/e

III. SHFMU" Hamëz Thaçi" Xërxe

Një mësimdhënës/e për Programin Fillor

IV. SHML" Ukshin Hoti" Krushë e Madhe

Një mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës Gjermane, me kohë të caktuar (deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë).

Kushtet për konkurim:

Për vendet e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas U.A.10/2018, (Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm), ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen duke ia bashkangjitur dokumentet përkatëse, në zyrat e DKA-së.

Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar,
- Kopjet e certifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime.
- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.
- Dokumentet pranohen deri më datë, 25.10.2019, deri në ora 15.00
- Intervistimi me shkrim i kandidatëve bëhet më datën 28.10.2019 në SHMLP" Selajdin Mullaabazi- Mici" në Rahovec, duke filluar nga ora 10.00.
- Intervistimi me gojë i kandidatëve do të realizohet me datë, 30.10.2019, në DKA duke filluar nga ora 10.00.

Rahovec,
10.10.2019



Avni Morina, Drejtor

Avni Morina